

SHP TETOVË

## TAKIM ME PENSIONISTEN GËZIME HAJREDINI

“Çdoherë u përkushtohemi obligimeve. Problemet në jetë dhe familje i kam rritur me sukseset që i kemi arritur”, thotë Gëzime Hajredini

Për periudhën prej shtatë vjet si pensioniste, Gëzime Hajredini nga Tetova ka marrë pjesë ose personalisht ka formuar tri shoqata për qëllime humanitare. Në vitin 2003, para pensionimit, ka formuar dhe vet bëhet kryetare e shoqatës “Dora e artë”, në kuadër të IQC “Antika” – rrjet i cili funksionon në tërë Maqedoninë, si asociacion universal qytetar për të drejtat e njeriut me bazë të veprimtarisë në sferën humanitare dhe sociale. Kjo shoqatë këtë vit shënon jubileun modest – 15 vjeçar të ekzistimit dhe punës së suksesshme.

Krahas obligimeve familjare dhe aktiviteteve në shoqata, kjo grua humane dhe pensioniste në mënyrë aktive përfshihet edhe në punën e SHP Tetovë edhe gjatë mandatit aktual nga baza e vet, dega “Radovan Coniq” është zgjedhur delegat në Kuvend. Dhe jo vetëm ajo, Gëzimja është edhe anëtare aktive në grupin e këngëtare në gjuhën shqipe, si pjesë e përbashkët, që përbushë këngë e valle edhe në gjuhën maqedonase të njohur si SHKA e SHP Tetovë, me kualitete të larta të manifestuara në trajtimin e folklorit burimor

maqedonas dhe shqiptar të rrethit të Tetovës.

“Në kuadër të Shoqatës “Dora e artë”, themelues dhe kryetar i së cilës jam unë, kemi formuar grupin e këngëtarëve “Teuta”, me qëllim që t’i ruajmë nga harresa këngët e vjetra qytetare, karakteristike për rrethin e Tetovës. Së shpejti i anëtarësuan vajza dhe gra të moshave të ndryshme. Vetëm se në vitin 2008 organizuam festivalin “Teuta”, i cili gjithashtu këtë vit shënon një jubile me vend të 10 vjetorit të ekzistencës. Në fillim, mbajtjen e festivalit e financonte Ministria e kulturës, ndërsa viteve të fundit na mbështetë vetëqeverisja lokale e Tetovës. Me më të moshuarat, kryesisht pensioniste, kemi bërë një grup të veçantë, i cili me sukses po paraqitet në revytë folklorike të organizuara nga LSHPM. Edhe pse ato janë me karakter revyal dhe mbahen në nivel rajonal, ndërsa më të mirët edhe në revynë republikane, ne lëmë një përshtypje të madhe në paraqitjen e dokeve të dasmave. Pensionistet tona kënaqen në eventet për të cilat ndajnë kohë të lirë për



përgatitje, njëkohësisht edhe për gjëra specifike (dajre, kavalje, madje edhe veshje) marrin pjesë edhe me mjetet e tyre vetanake”, thotë bashkëbiseduesja jonë.

Gëzime Hajredini posaçërisht veçon pjesëmarrjet në festivalin ndërkombëtar të pensionistëve në Lubjanë (Slloveni), ku SHP Tetovë ka përfaqësuar LSHPM në vitin 2013.

Fëmijëria e Gëzimes është e lidhur me fshatin e saj të lindjes Rasadishte, i cili gjendet në pjesët e ulëta të Malit Sharr, menjëherë mbi Tetovë. Dëshira për arsim i përbushet me ecjen e përditshme nga tre kilometra në një drejtim deri në shkollën “Përparimi” në Reçicë të Madhe. Notat shumë të larta ishin sfidë që ajo të vazhdojë në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë, në një klasë me 45 nxënës, ndërsa vetëm tre prej tyre femra. Dy prej shoqëve të saj të klasës u bënë mjeke shumë të njohura, ndërsa ajo regjistroi drejtësinë, por pas vitit të tretë u martua, dhe në vend të juristes, u bë mësuese. U pensionua me mbi 44 vite stazh të punës.

“Çdoherë u përkushtohemi obligimeve. Problemet në jetë dhe familje i kam rritur me sukseset që i kemi arritur”, thotë Gëzime Hajredini. (Gojko Eftoski)

MBLEDHJA E 16 E KETË LSHPM

## Miratohen Raportet për punë për vitin 2017

Më 16 shkurt të vitit 2018 Këshilli ekzekutiv i LSHPM ka mbajtur mbledhjen e vet të 16-të me të cilën udhëhoqi kryetari i LSHPM Dragi Argirovski, ndërsa përveç anëtarëve të KE, kanë marrë pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM, Besnik Pocesta dhe kontabilisti i LSHPM Petar Andreevski dhe të tjerët. Raportin për punë i LSHPM në vitin 2017 e arsyetoi Saltir Karovski, nënkryetar i KE të LSHPM dhe tha se në të njëjtin janë përfshirë të

gjitha aktivitetet më të rëndësishme gjatë vitit të kaluar. Në mbledhje anëtarët janë informuar edhe për punën financiare të LSHPM gjatë vitit 2017. Shpjegim të materialit më herët të distribuar dha kryetari i KM, Mitre Stojanovski. Nga materiali janë të qarta shumë shenja pozitive për punë të përgjegjshme dhe realizim të planeve në kuadër të planit financiar për vitin 2017. Në mbledhje u miratuan të dy dokumentet dhe vendimi për llogarinë

përfundimtare për vitin 2017.

Për projektin e LSHPM “2018 - Viti i inkluzionit të njerëzve të moshuar” fjalim kishte Dr. Stojançe Stefanovski dhe Stanka Trajkova sekretare e KE të LSHPM. Në mbledhje u formuan Këshillat organizativ për revytë dhe garat sportive rajonale dhe u përcaktuan nikoqirët e revyve rajonale, si dhe mjete për mbështetje të të njëjtave, ndërsa u sollën edhe vendime të tjera për punën aktuale. (K.S. Andonova)

SHP STRUGË

## Këshilla falas për Marrëveshje për përmbajtje, dhurata, testament

Më 12 shkurt 2018 në Strugë u mbajt një ligjëratë falas për pensionistët me titull “Marrëveshje për përmbajtje, dhuratë, testament”, temë interesante posaçërisht për personat e moshuar. Ligjëratat ju dedikua shoqatave të pensionistëve të Strugës, Vevçanit dhe Llabunishtit, gjegjësisht për të gjithë qytetarët mbi moshën 60 vjeçare dhe familjet e tyre. Ligjërues ishte avokatja e suksesshme Olivera Docevska nga Shkupi, me përvojë 17 vjeçare në sferën e së drejtës dhe të drejtave të njeriut, marrëdhëniet pronësore-juridike dhe procedurës juri-



dike, magjistër e marrëdhënies ndërkombëtare dhe diplomacisë, aktiviste e të drejtave të njeriut dhe Kryetare e organizatës për të

drejtat dhe liritë e njeriut “Justicia”, poeteshë, përkthyes, kolumniste...

Avokatja Docevska foli për

aspektet për mbrojtjen e pronës dhe personit gjatë posedimit të pronës me testament, marrëveshje për dhuratë dhe marrëveshje

SHP KUMANOVË

## Ekonomia, ekologjia dhe energjia



SHP Kumanovë dhe SHQJUSTICIA kanë organizuar punëtorinë e dytë edukative në kuadër të projektit “Vetëbesimi dhe inkluzioni social - parakusht për pleqëri të dinjitetshme” me temë: Kontributi i pensionistëve në aktivitetet ekologjike për përmirësimin e gjendjes së natyrës dhe mjedisit urban.

Punëtorija u mbajt në EURO KOLEXH ku morën pjesë 21 pensionistë, ndërsa e menaxhuan Olivera Docevska nga Justicia dhe Jasmina Todorovska nga SHP Kumanovë, ndërsa ligjërues ishte Mirko Makreshanski, doktor i shkencave për mbrojtje të mjedisit jetësor. Tema u prezantua në katër tërësi: Resurset natyrore; Menaxhimi me resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm; Ndryshimet klimatike dhe dëmtimi i mbështjellësit të ozonit dhe Pensionistët në aktivitetet për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit urban.

Dhjetëra pjesëmarrës kanë debatuar për gjendjen aktuale me ndotjen e ajrit, për ujërat, tokën, për gjendjen e pyjeve dhe gjelbërimin e parqeve, shfrytëzimin e mbetjeve të mineraleve, pesticideve dhe mbeturinave të ngurta. Aty u theksua edhe shqetësimi për mbeturinat e mjeteve elektroteknike, video, kompjuterike dhe komunikuese. U potencua se ekziston nevoja që secili qytetar të ketë të ndërtuar kulturën etike ndaj natyrës, biosferës, vetes dhe njeriut. Mes tjerash u kërkua që edhe pensionistët të përfshihen në eko-patrulla dhe eko-aksione për mjedis të pastër, si dhe në manifestime me raste të ndryshme dhe data të rëndësishme në këtë sferë. Nga punëtorija doli edhe konkluzioni: njeriu është mrekullia e natyrës, krijesë shoqërore dhe sociale, i cili për 100 vjet bëri teknikë dhe teknologji cilësore, lufton me ndryshimet klimatike dhe kërkon burime të reja të ripërtëritura të energjisë. Megjithatë, optimizmi ende ekziston. Nuk ka dilema: njeriu do të gjejë zgjidhje për çdo gjë.

(Mirko Makreshanski)